

Korifeu i letrave shqipe



Nga Ilir Demalia - 13:50, 30/12/2018

Edhe kombi ka të drejtë përr reth meje

Më 30 dhjetor të vitit 1940, në moshën 69 vjeçare, pas një plomonie që kishte marrë gjatë një vizite në Troshan, në fillim dhjetor 1940, atje ku kishte filluar jetën shërbetare dhe letrare, kthehet në Shkodër, i sëmurë rëndë, dhe pushon për të shkuar në amshim. Ai, i cili sundoi për gati gjysmë shekulli letrat shqipe, politikën, diplomacinë.

Ai që na dha alfabetin latin në Kongresin e Manastirit, si kryetar i Komisionit letrare të alfabetit, i cili, me dijen, autoritetin, dashurinë për vendin dhe kombin, detyroi kongresin që mos të futeshin harfet turke dhe ciriliket por, alfabeti i Shoqërisë Bashkimi krijuar nga kleri françeskan, Abati Mirditës Prenk Doçi dhe nga Ndoc Nikaj e Pashk Bardhi dhe at Fishta (Vigani-Veriut), me alfabetin latin e niste Shqipërinë nga Europa Perëndimore nën pushtimin Otoman 500 vjeçar.

Para se me mbyllë sytë, Vigani Veriut At Gjergj Fishta, i rrethuar nga françeskanët e populli i Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë, të përbotur për dhimbjen që po i shkaktonte njeriu që kishte punue për pese dekada për popull e komb e vend të vetin, At Fishta lëshoj këtë testament:

‘Nuk po më vjen keq se po des, mbasi të gjithë atje do të shkojmë, por deka po më vjen e randë, se tan jetën e kam shkri për me pa një Shqipni të lirë e në vedi, ndërsa sot po e lâ të shkelun prej ushtrive të huaja.

Po des. Ju tash keni me mendue për salikim, por edhe kombi ka të drejtë për rreth meje.

Po des konden (i kënaqur) përse kam punue për fe, Atdhe e për provincën tonë. ‘

Në historinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve, por edhe atë botërore nuk mund të gjëndet një figurë kaq e lartë, kaq poliedrike.

Meshtar, politikan, poet, publicist, linguist, arkitekt, piktor, diplomat, filozof të gjitha këto në një shkallë të epërme.

Këtë Vigan të tokës shqiptare e gjen kudo.

Si maratonomak i pavarësisë.

Si njeriu i alfabetit shqip.

Si mbrojtës i çështjes shqiptare në Kancelarite Europiane dhe deri në Washington me argumentet dhe charmin e tij tronditi kancelaritetë.

Si mësues që hapi shkollat shqipe dhe përgatiti një program brilant për sistemin shkollor, në një kohë që 90% e shqiptarëve nuk dinin shkrim e këndim. Me që jemi në aktualitetin e krizës universitare, ja çfarë shkruan Vigan Veriut në programin e tij:

‘Po këtu, gjithkund e prej gjithkujt po bahet politikë... E mbas këso qëllimesh politike e fetare kjo ministri ep bursat shkollore, emnon mësuesit e drejtorët e shkollave, dan materialin shkolluer.

Unë, ma tepër Ministrinë e arsimit e padis se shkollat nuk i çilë mbas një kriteri të arsyeshëm, të caktuem e të parashkoqitun mbas interesave të përbashkëta t’Atdheut, por mbas hamendjes së Ministrin apo të këshilltarëve të tij, thue se në këtë veprim ishin tuj përdorue gjanë e pasuninë e vet e, jo të komit.’

Të flasësh për at Fishtën, poetin që ka 64 mijë vargje, i dyti mbas Nekrasovit të Ruisë, dhe për njeriun që ka pasuri leksikore të pakrahasueshme, 14 mijë fjalë në veprën tij, i dyti mbas Shekspirit, i cili ka 17 mijë fjalë. Do të duhen fashikuj pafund gazetash e librash.

Le ta kujtojmë sot këtë njeri që i dha aq shumë kombit dhe ende nuk e ka një monument!!! Është njësoj sikur Italia mos të ketë monument për Dante Aligerin, Gjermania për Gëten, Anglia për Shekspirin, Franca për Balzakun, Rusia për Nekrasovin apo Pushkinin, e...

Shtëpia ku jetoj vigan rrënohet, varrin ja shkatërruan komunistët, të cilët e ndaluan çdo gërmë të veprës së tij, sa nuk e përmendnin as si kryetar i Komissë Letrare të Kongresit të Manastirit.

O Zot, -shkruante Vigan,- pse gjuen me rrufe lisa e male kot?!

Tradhëtarët na lane pa atdhe.

Le ta kujtojmë sot me çfarë kanë thënë për Padren e madh, elita e mendimit europian dhe shqiptar për të thyer heshtjen e qeverive që bëhet për këtë vigan, të cilin e nderoj Europa me titujt ma të naltë dhe në 1936 ishte kandidat për çmimin Nobel, megjithese nuk i përmendet.

Kurorë Argjëndi, nga Klubi ‘Gjuha shqipe’ i Shkodrës (1911).

Dekorata Mearif, nga Mbretëria Turke (1912).

Dekorata Ritterkreuz, nga Mbretëria e Austrisë (1912).

Penë floriri, nga qyteti i Beratit (1913).

Medaglia di Benemerenzza, nga Papa Piu XI (1925).

Lector Jubilatus, nga Paria e Urdhnit françeskan (1929).

Dekorata Phoenix, nga Greqia (1931).

Anëtar i shtatë akademive europiane, të Francës, Austrisë, Malit Zi, Greqisë, Italisë, Turqisë, Kroacisë.

Ja çfarë thonë për At Fishtën të cilin elita francize e ka quajtur 'Tirteu Shqipërisë'

'Pak kush kujtoj, në letërsi të mbarë botës, ia del at Fishtës si poet satirik, si i tillë me një furi të çuditshme ther e pren aty ku djeg.'

Albanologu Fulvio Cordignano,

'Fishta është ndër të parët e ndër më të mëdhenj atdhetarë, të cilët në kohë më të vështira bënë çmos për t'a mbajtur gjallë lëvizjen kombëtare kundër dhunës barbare të qeverisë turke, kundër lakmisë dhe përrake serbe dhe kundër propagandës greke. Kudo që shtruhej çështja e Shqipërisë, At Fishta gjënde aty pranë e, ku me vepra e ku me shkrime, sidomos me poezinë e tij të gjallë, zgjonte nga gjumi më të plogështit dhe mbante gjallë gjithmonë shpresën e ardhmërisë.'

Geatano Petrotta

'Fishta, shikuar n'atë qënien e vet, pa dyshim është krejtësisht romantik. Rëndësija e tij mbi kombësin, zgjedhja e lëndës, fuqija, gjallnija e nderimi i shprehjeve të tija, sidomos trajta e përmbajtjes së veprës së tij kryesore Lahuta e Malcís – me mbishkrimin tërëhjekës të dokeve e të zakoneve kombëtare e bëjnë dëshmi mjaft t'qartë ... Fishta, ky gjenueni i rrënjës në tokën amtare të popullit shqiptar, qi për shkak të njohjes së thellë të tij mbi literaturën e popujve klasikë e mbi jetën shpirtnore të kombeve të tashme të Evropës, u kap në majë ma të naltat të kulturës.'

Prof. Dr. Norbert Jokl

'... Lahuta e Malsisë e Gjergj Fishtës, jo vetëm që ka rëndësi në pikëpamje artistike, por ajo, porsì vëna e mirë që sa më shumë vjet kalojnë aq më vlerë merr, tue qenë se ajo është pasqyra, magazina e kopja besnike e jetës, e shpirtit, e dëshirave e përpjekjeve, e luftës dhe e vdekjes së shqiptarëve: me një fjalë, Lahuta është shprehja më e karta e dokeve të fshatarëve, banorë të Maleve të Veriut. E prejse doket e lashta të fiseve malore janë gjykuar të zhduken nga tallazet e forta të civilizimit, lexuesi, letrari, folkloristi, juristi e historiani i nesërm kanë për t'ia dijtë për nder në dhetë a qindvjetët e ardhshëm Poetit, i cili në Lahutë të

Malsisë na la një ritrat (portret) të shqiptarit, të përshkruem nga goja e dëshmitarëve njëkohsorë, ashtu si këta e gjetën në agimin e shekullit të XX-të, me atë ndryshim të vogël që shqiptari pësoi ç'prej kohëve të largëta të iliro – thrakëve.'

Shqipëria pat një fat t' madh e t'jashtzakonshëm, shka nuk e paten popujt e tjer, veçse mbas qindra vjetsh të një jete letrare, pat të madhin, të naltuemin përmbi t'gjith, atë, qi u pshtet në popull t'vetin e n' gjuhen e tij e qi me vjersha t'veta ndezi flak zemrat n'popull, pat zhenin poetike t'At Gjergj Fishtes

I rrënjosur krejtësisht në popullin e vet, Fishta ka dashur të përgjonte si flasin burrat e gratë e maleve. Ka marrë prej tyre mënyrat e nëmëve, të mallkimeve e të urimeve dhe çdo gjë e ka shkrirë me mjeshtri në poezitë e veta'.

...'Koha e ardhshme ka me dijtë me çmue edhe ma mirë randësinë e këtij njeriut, sidomos kur vjershat e tij të jenë përkthye ndër gjuhe ma të përhapuna.

Maxmilian Lambertz

Aq sa mund të kuptohet Greqia pa Homerin, Italia pa Dante Aligerin, Anglia pa Shekspirin, Gjermania pa Eposin e Nibelungëve, Franca pa Balzakun, aq mund te kuptohet dhe Shqipëria pa At Gjergj Fishtën.

Gustav Mayer

'Patër Fishta njihët si poeti më popullor i shqiptarëve, si poeti më i përzemërt i këtij populli... Si këte kemi edhe një të madh tjetër: Rabindranath Tagora.'

Erwin Stranik

'Patër Fishta...me veprat e tij në poezi e në prozë arriti të kurorëzohej me dafinë si më i madhi poet kombëtar, ai është tharmi i poezisë popullore shqiptare dhe më i kulluari shkrimtar i Arbërisë.'

Anton Baldacci

'Fishta mori prej popullit gjithçka që gjet të hijshëm, të madhnueshëm e të fuqishëm, e pors një piktor i Zoti, e shndrroi në shpirtin e vet, tue e riprodhue në një mënyre e cila asht vetëm e tija, prandej, origjinale.'

At Anton Harapi

'Atë Fishta është marrë me secilën gjini letrare dhe në

të gjitha ka qenë i suksesshëm. Mirëpo, jashtë Shqipërisë ai është i njohur vetëm si autor i Lahutës së malcis', një epike pastorale e kalorsiake, përkthimi gjerman i së cilës botuar në Laipsig është i dobët, meqë nuk ka qenë e mundur të përkthehet muzika e ritmit Fishtës dhe coloriti tij.

Kot së koti përpiqen grekët e sotëm të kërkojnë në letërsinë e tyre një vepër më të plotë se 'Lahuta' e Gjergj Fishtës.'

Faik Konica

'Tue lexue Lahutën e tij, përplot me teprica kangësh rapsodike të pa emën, të duket se je tu e vështrua popullin shqiptar kah i këndon vedvetit, me fjalët e Fishtës, ma t'kulluetën kangë, e cila shpërthen nga një gjak misterioz që rrjedh në zemrën e tij Ilire'.

Ernest Koliqi

'Shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar, ky është si të thesha monopolitetioliteti' gjenetik i artit të Fishtës, kështu do t'i thesha me dy krahasime paralele gjithë poezisë që na ka falur ky vigan i kombit...

Gjithë vepra poetike e shoqërore e At Gjergj Fishtës u pat zhvilluar rreth postulatit fetar dhe kombëtar. Me të vërtetë, ku ka ide dhe ndjenjë më të madhe, më të denjë për të derdhur dhe kënduar në art, se sa ideja e Zotit, ideja e Atdheut!

Fishta e ka veshur lirizmen e tij të vërtetë si tërë kryeveprën epike në një stil thelbësisht origjinal të shkukur për rrënje nga trupi dhe nga truri i racës, dyke fituar me këtë atavizmë artistike gjithë të drejtat e përjetësisë ndaj Kombit- anasjelltas dyke i dhënë Kombit privilegjin e mburrjes dhe të mbështetjes së kurdoherëshme mi Këngëtorin e madh të fateve të tija. Sikundër e pat lënë shprehur për trashëgim me verbin solemn të gojës së vet përmes shokut të pandarë At Pal Dodajt dy ditë përpara vdekjes, të Premten më 27 Dhjetor 1940, ora 3.30' pas mesdite, në Spitalin e Shtetit në Shkodër: trashëgim i shqiptuar për kuptim të math në gjuhën paralajmëronjëse dhe të djegur për Atdhe të Dantes: ... fundi i fundit, dhë Kombi ka të drejta mi mua

Lasgush Poradeci

Ne vitin 1935 At Fishta pat përfunduar 'Lahutën e Malcis'. Ati i dërgon Lahutën Eqerem Cabejt i cili ishte në Viene sëbashku me një kartolinë urimi për Vitin e e Ri. Pas dy tre muajsh Cabej i kthen përgjigje At Fishtës, ku ndërmjet të tjerave i shkruan:

'Padre, të falenderoj për urimet e Vitit te Ri, por të falenderohem njëmijë herë për veprën që më dërgove Lahuta Malcis, të cilën, pasi e lexova dhe rilexova mbi 100 herë, jam dashurue aq shumë e këtë vepër sa po më detyron të bëhem katolik.'

Në vitin 1936, gjuhëtari i shquar dhe studiuesi i letërsisë, albanologu më i madh, Eqerem Çabej në studimin 'Për gjenezën e literaturës shqipe', kur flet për Fishtën dhe veprën e tij, ndër të tjera shprehet: Një provë që nuk e kishte bërë me sukses letërsia shqipe më parë, bëhet me sukses të jashtëzakonshëm nga ky autor. Me Lahutën e Malcisë, Gjergj Fishta na tregohet poet me fuqi epike të lindur, rrëfimi i tij është plot gjallëri dhe rrjedhje. Vepra e këtij

autori është e mbështetur në këngët e veriut mbi trimëritë të cilat në veprën e re thuren duke u përsosur e fisnikëruar.

Fishta zë fill me njësinë e vogël të fisit për të mbaruar në njësinë e madhe të kombit, ia fillon me bariun e moçëm Marash Ucin dhe mbërrin ke Abdyl Frashëri me Lidhjen e Prizrenit. Duket qartas përpjekja e tij të zgjëroj botën në një brendi më fort nacionale, të ngrejë kështu veprën në sferën në një brendi kombtare. Kështu vepra e tij ka marrë karakterin e një eposi kombëtar

... duke qenë njëkohësisht në një farë kuptimi edhe një eposballkanik. Një dritë jete homerike shkëlqen mbi veprën e tij: si nëdukje të zanave që u përngjajnë Dianës e Atenës

Gjergj Fishta është bërë sidomos me Lahutën e Malcisë përfaqësuesi më i parë i literaturës së sotme shqiptare.

Eqerem Çabej

‘Lahuta e Fishtës çfaq ndjesitë më të thella dhe karakteristikat me të kristalizuara që i ruajti raca shqiptare përmes shekujve plot shtrëngata...Shqipëria e tërë përfshihet e dehur nën vargjet e kësaj Lahute, e cila bëhet pronë kombtare, mish e gjak, ndjenjë e mish i përbashkët’.

Sterio Spase

‘Si vetimë u përhap an’ e kand të Shqipnisë lajmi i hidhët i vdekjes së poetit t’onë Kombëtar, At Gjergj Fishtës dhe e mahnitun mbeti sot mbarë bota shqiptare, tue kujtue emnin zamadh të autorit të ‘Lahutës së Malcisë’ që ka këndue, si dikur Omeri, burrnin e besën e fisit tonë, që ka ndezë zemrat e Shqiptarëvet, si dikur Tirteu, i vjetërsisë. E me të drejtë i kan thënë Fishtës ‘Tirteu i Shqipnisë, se sikurse ai me elegjitë e tij ndezi zemrat e Spartanëve për luftë, njashtu dhe epopeja e ‘Lahutës’, odet dhe elegjitë e ‘Mrizit të Zanave’ e të poezive të tjera kanë mbledhë në zemër të djelmnisë sonë dashuninë e pamasë për truellin e të parëve dhe për gjuhën amtare. Këto dy ideale: Atdhedashunia dhe ruajtja e gjuhës si dritë e synit, lavrimi dhe përdorimi e saj kanë qenë poetit rreth së cilave shtrihej vepra e çmueshme e Fishtës. E s’ka kush tjetër veçse ne arsimtarëve që kemi pasë e kemi nëpër duer edhe ua kemi mësue nxënësve poezitë e tij, që e çmon ma mirë veprën zamadhe të tij, e cila sot si një far i madh dritëdhanës ka ndriçue mendjen e djelmnisë sonë, si një Ungjill shkëndimadh morali ka zbutë e ka edukue zemrën e saj’

Aleksandër Xhuvani (Fjala e tij ne varrimin e Fishtës)

‘ Fishta është elefant i mbuluar nga pluhri gjatë regjimit komunist’

Petro Marko

‘Lahuta Malsisë’ një vepër për analfabetët, për çobanët, për ambientet pastorale, për antishqiptarët, proitalian për zyrtarët që nuk u pononte truri për me gjetë thelbin e saj

monstruoz. Siç ndodhte shpesh me krijimet që kanë vulën e nacionalizmit, vepra e Fishtës, e sidomos 'Lahuta Malsisë', fitoi një popullaritet të veçantë, qoftë me rrethet zyrtare, sidomos ato proitaliane e më pas kuislinge, qoftë me shtresa të prapambetura e disa herë analfabetë të popullsisë, të cilat nuk ishin në gjëndje të kapnin thelbin e saj, por e shihnin ate pjesërisht si një zinxhir episodesh.

Veprës së Fishtës, sidomos 'Lahutës së Malsisë' i u ngrit një kult e iu u bë një reklamë e tillë, saqë rrezikonte ta kthente në një gur varri sa ti merrte frymën gjithë letërsisë shqipe.'



“RRËNJËT TONA”